

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË
TË DREJTËSISË PËR VITIN 2020 (SHKURT-DHJETOR)**

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë;

Duke mbajtur parasysh rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në hetimin e shkeljeve të dyshuara nëpërmjet ankesave të paraqitura nga çdo person fizik ose juridik, por edhe kryesisht bazuar në të dhëna publike ose të siguruar në kuadrin e inspektimeve institucionale e tematike;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorin e Përgjithshëm në kuadër të përmbushjes së detyrave funksionale;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me partnerët ndërkombëtarë,

Vlerëson punën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në drejtim të:

- Transferimit dhe nisjes së shqyrtimit fillestar të një numri të madh ankesash lidhur me veprimtarinë e magistratëve, organizimin e burimeve njerëzore, si dhe nisjen e procesit të rekrutimit të inspektorëve dhe stafit të Zyrës.

- Raportimeve të detajuara vjetore dhe periodike, si dhe informimeve drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme dhe Kuvendit të Shqipërisë për aktivitetin e institucionit.

- Angazhimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në përgatitjen e kuadrit rregullues të veprimtarisë institucionale në zbatim të nenit 204, shkronja "c", të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

Bazuar në analizën e të dhënave për periudhën shkurt –dhjetor 2020, të referuara në raportin e paraqitur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Kuvendi i Shqipërisë konstaton:

- Angazhimin për fillimin e shqyrtimit të një numri prej 3054 ankesash të regjistruara nga muaji shkurt deri në dhjetor 2020.
- Miratimin e 8 vendimeve për fillimin e hetimit disiplinor, përkatësisht 6 hetime disiplinore të iniciuara kryesisht dhe 2 hetime disiplinore të iniciuara pas rasteve të paraqitura nga institucionet pranë ILD-së.
- Dhënien e 184 vendimeve për shqyrtim të ankesave, nga të cilat për 142 janë dhënë vendime për arkivimin e ankesave pas shqyrtimit fillestar dhe 42 vendime për verifikimin e ankesave pas shqyrtimit fillestar.
- Pas kryerjes së procedurave të verifikimit, miratimin e 7 vendimeve për fillimin e hetimeve disiplinore ndaj magjistratëve, si dhe paraqitjen e 4 kërkesave për fillimin e procedimeve disiplinore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
- Inicimin e inspektimit tematik pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, gjykatave të apelit, si dhe zyrave të prokurorive pranë tyre për trajtimin e kërkesave me objekt “Lirim me kusht”.
- Hartimin, përpunimin dhe miratimin e “Planit Strategjik dhe planit të veprimit 2020-2022”.
- Hartimin dhe miratimin e Kodit të Etikës së institucionit.
- Hartimin dhe miratimin e modelit të formularit të ankesës.
- Rezultate konkrete të mekanizmave të procedimit disiplinor të disa magjistratëve, duke i shërbyer kështu kthimit të besimit të publikut tek institucionet e drejtësisë, si një rezultat i prekshëm i reformës në drejtësi.
- Ngritjen nga e para të infrastrukturës fizike e njerëzore të një institucioni krejt të ri si në formë, ashtu edhe në përmbajtje.

Bazuar sa më sipër, Kuvendi i Shqipërisë nxit Inspektorin e Lartë të Drejtësisë:

1. Të veprojë me ritme të shpejta për shqyrtimin e ankesave të paraqitura pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
2. Të forcojë më tej bashkëpunimin me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe institucionet e tjera shtetërore në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi për të gjitha proceset që ndikojnë në zbatimin e detyrave të përcaktuara.
3. Të informojë vazhdimisht Kuvendin e Shqipërisë për problematikat e hasura gjatë ushtrimit të detyrave duke rekomanduar edhe zgjidhjet përkatëse.

Kuvendi i rekomandon Inspektorin të Lartë të Drejtësisë:

1. Krijimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve për procedurën hetimore, hartimin e dispozitave të hollësishme për administrimin e këtij sistemi, si dhe bërjen publik të informacionit të pjesshëm sipas përcaktimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në përputhje dhe në zbatim të nenit 137 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Ngritjen e bazës së të dhënave për ankesat e transferuara nga ish-KLD-ja dhe të administruara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me qëllim grupimin e tyre dhe hartimin e një radhe përparësore shqyrtimi.
3. Bashkërendimin e punës dhe shkëmbimin e vazhdueshëm të informacioneve me KLGJ-në, KLP-në dhe organet e rivlerësimit kalimtar, që janë përgjegjëse për sistemin e karrierës së magjistratëve lidhur me ekzistencën ose jo të procedurave disiplinore të nisura ose ankesave të

depozituara pranë ILD-së për magistratët që aplikojnë për ngritje në detyrë brenda sistemit të karrierës.

4. Forcimin e marrëdhënieve institucionale me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, me qëllim trajtimin në afate të arsyeshme të procedimeve disiplinore për prokurorët.

5. Vijimin me ritme të shpejta të punës për hartimin e manualit të hetimit disiplinor, hartimin e rregullores për trajtimin e ankesave dhe metodologjisë për inspektimin.

6. Vijimin me ritme të shpejta të punës për përfundimin e procedurave të rekrutimit të inspektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

7. Hartimin dhe miratimin e planit vjetor të inspektimeve institucionale e tematike dhe bërjen publik të tij në faqen zyrtare të institucionit.

8. Promovimin dhe rritjen e ndërveprimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me qytetarët nëpërmjet aktiviteteve, informimeve periodike, pasurimit informativ të faqes duke përdorur çdo kanal tjera të komunikimit publik.

Miratuar në datën 3.6.2021